



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Nr. ___ Prot.

Datë: 30/12/2008

VENDIM

Nr.99 datë 30/12/2008

“Rekomandim për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1110, datë 30.07.2008, pasi kufizon konkurrencën në treg”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30/12/2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Mbi kufizimet e konkurrencës nga vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase”

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 70, pika 2,

Pas shqyrtimit të:

- Raportit të vlerësimit të kufizimeve të konkurrencës në tregun e karburanteve si pasojë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Ankesës së Shoqatës të Shoqërive Hidrokarbure me Nr.18/1, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 546 Prot, datë 19.12.2008;

VËREN SE:

I. Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: “Raportit të vlerësimit mbi ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në tregun e karburanteve” e në mënyrë të veçantë për produktin “lëndë djegëse diesel sipas standartit S SH EN 590”; relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ankesës së Shoqatës së Shoqërive Hidrokarbure konstaton se:

Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase”, në

tregun e produktit lëndë djegëse diesel, vendosen kufizime të konkurrencës për shkak të aplikimit të kushteve të ndryshme të tregtimit në lidhje me produktin vendas dhe atë të importit.

Ky diferencim është bërë për periudhën 1 janar 2009 -1 janar 2010 dhe periudhën 1 janar 2011 – 1 janar 2012. Pas datës 1 janar 2012 duket qartë se lejohet të merret nga importi apo prodhimi vendas lënda djegëse vetëm me përmbajtjes squfuri deri 10 mg/kg.

Pra, për të njëjtin produkt, i cili mund të merret si nga vendburimet e territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe nga importi, kemi kufizime, duke iu dhënë përparësi tregtimit të lëndës djegëse diesel të rafinuar nga vendburimet vendase deri në 1 Janar 2012.

Ky diferencim që bëhet është një shtrembërim i konkurrencës në kuptim të vendosjes në pozita të pabarabarta të konkurrentëve në treg dhe duke kufizuar ofertën e produktit drejt monopolizimit në kundërshtim me ligjin dhe Politikën e Konkurrencës.

Gjithashtu, ndër objektivat kryesore të Politikës dhe Ligjit të Konkurrencës përveç mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, është mbrojtja e konsumatorit dhe harmonizimi me Politikën e Mbrojtjes së Ambjentit.

II. Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore^{1/2}(CEFTA) sipas së cilës shteti shqiptar në kuptim të nenit 19 të kësaj marrëveshjeje merr përsipër *“të përshtatë çdo monopol shtetëror me karakter tregtar ose ndërmarrjet shtetërore tregtare që në përputhje me dispozitat e OBT –së nuk ekziston asnjë diskriminim ndërmjet ndërmarrjeve të palëve në lidhje me kushtet sipas të cilave tregtohen produktet”*;

Në bazë të nenit 20 të kësaj marrëveshjeje, çdo praktikë që vjen në kundërshtim me nenet 81, 82 dhe 86 të Traktatit të KE-së do të konsiderohet në kundërshtim me funksionimin e përshtatshëm të kësaj marrëveshjeje në masën që ato ndikojnë në tregtinë ndërmjet palëve³. Po sipas këtij neni deri në datën 1 maj 2010, shteti shqiptar detyrohet që të rregullojë konkurrencën e lirë në treg në kuptim të neneve 81, 82 dhe 86 të KE-së, parashikuar kjo dhe në nenet 27 dhe 37 të Ligjit Nr. 9591 datë 27. 07. 2006 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar”.

Sa më lart, Komisioni i Konkurrencës vëren se VKM Nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase”, kufizon ndjeshëm konkurrencën në tregun përkatës lëndë

¹ Hyrë në fuqi në 1 Maj 2007

² Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ndër të tjera është sigurimi i kushteve të drejta të konkurrencës që ndikojnë në tregtinë dhe investimet e huaja dhe të hapë gradualisht tregjet e prokurimit publik të palëve.

³ Palët e kësaj marrëveshjeje janë: Republika e Shqipërisë, Republika e Moldavisë, Bosnja Hercegovina, Republika e Malit të Zi, Republika e Bullgarisë, Republika e Rumanisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë.

djegëse diesel duke lejuar vetëm një burim prodhim-furnizimi, të krijuar me akt nënligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, germet “d” dhe “f” dhe 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Këshillit të Ministrave shfuqizimin e VKM Nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase” për të shmangur pengimet, kufizimet dhe shtrembërimet e konkurrencës në treg.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PERPALI

(_____)
Zv/Kryetar

Servete GRUDA

(_____)
Anëtare

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE